VENDIM
Nr. 116, datë 7.10.2013

PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES "MBI PROCEDURAT E EMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT DHE KOMPETENCAT E TIJ, NË ZBATIM TË NENIT 18, PIKA 4/C TË LIGJIT NR. 9072, DATË 22.5.2003 "PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE", TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 1, DATË 10.1.2013 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S

Në mbështetje të neneve 9 dhe 18 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 19 të rregullores "Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij", në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.10.2013, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e rregullores "Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij", në zbatim të nenit 18 pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo

TEKSTI I NDRYSHIMIT TË RREGULLORES

Pika "a" e nenit 6 shfuqizohet.

Pika "c" e nenit 6 ndryshohet si vijon: "Të ketë një eksperiencë pune si drejtues ekzekutiv për një periudhë jo më pak se 5-vjeçare në sektorin publik apo privat".

Pas pikës 7 të nenit 12, shtohet pika 8, me përmbajtje si vijon: "Brenda një periudhe 30-ditore nga përfundimi i këtij procesi, administratori i përkohshëm njofton ERE-n".

Pika 3 e nenit 14 ndryshohet si vijon: "Harton një protokoll të pagesave ndaj palëve të treta sipas rregullave të modelit të tregut, i cili duhet të miratohet paraprakisht në ERE".

Pika 1, "a", "iii" e nenit 17 shfuqizohet.

Fjalia e fundit e pikës 3 të nenit 17 shfuqizohet.